



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:063189

Datë: 07.04.2022

Numri i dokumentit: 02895983

P. nr. 77/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. P. nga fshati L., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.86/2020 të datës 28.05.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të mbajtur më 02.02.2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi, të akuzuarit A.P., më **07.02.2022, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. P.** nga i ati I., e ëma H., e lindjes B., i lindur më ..., në fshatin L., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, i ati i 1 fëmije, ka të kryer shkollën fillore, pronar i marketit dhe restoranti "B.", në L., i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë 17.12.2019, rreth orës 20:00/h, në fshatin L., Komuna e Malishevës, pikërisht në restorantin "B.", i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyre që derisa i dëmtuari – N. (H.) K. po ashtu nga fshati L., ishte shkuar në lokalit të lartcekur për të pirë kafe, e që pasi kishte pirë kafe i njëjti kishte kërkuar një gotë ujë, pronari i lokalit tani këtu i pandehuri nuk e shërben me pretekst se i dëmtuari po tallej me te dhe në shenjë revolte kërkon nga i dëmtuari që të largohet nga lokali, ku i dëmtuari largohet pa paguar kafën që kishte pirë, në atë moment i pandehuri revoltohet, e kapë për fyti dhe e godet një here me shuplake në fytyrë, me ç' rast të dëmtuarit N. i shkakton lëndime të lehta trupore sipas Akt ekspertizës mjeko - ligjore të Dr. F. D. të datës 15.05.2020.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 2,4,7,17,21,38,39,40,43,69,70,185 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së dhe neneve 248 dhe 365 të KPPRK-ës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin **A. P.** e dënon me dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, ekspertizën mjeko ligjore 20.00 euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 € të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari N. (H.) K. nga fshati L., Komuna e M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.nr.86/2020, të datës 28.05.2020, kundër të akuzuarit A. P. nga fshati L., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 02.02.2022, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokuroria e shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës bëri përmirësimin e emrit të babait të pandehurit dhe datëlindjen e të pandehurit.

Prokurori i deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari N.K. deklaroi se nuk kërkoj që të dënohet i akuzuari dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, pasi që më të pandehurin jemi pajtuar menjë herë pas veprës penale.

I pandehuri A. P. deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, me të dëmtuarin jemi pajtuar dhe nga ajo ditë nuk kemi pasur probleme ku kjo shihet se në gjykatë vijmë së bashku të dëmtuarit i kërkoj falje dhe i premtoj gjykatë se nuk do të përsërisë vepër tjetër penale, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj më gjobë.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti fillestar i aksidentit nr. ..., i datës 09.12.2019; raporti policor mbi marrje në pyetje të dyshuarit/ pandehurit A. P., nr. ... i datës 11.12.2019; raporti policor mbi marrje në pyetje të dëshmitarit/ dëmtuarit N. K., nr. ... i datës 09.12.2019; Q.K.M.F. M. – raporti mjekësor nr. ..., i datës 28.12.2019; raporti i policit B. K., i datës 09.12.2019; ekspertiza mjeko – ligjore e Dr. F.D. MD FMD, i datës 15.05.2020 për N. K., si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarinimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarinimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është hera e parë që ka kryer vepër penale dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë vepër tjetër penale si dhe me të dëmtuarin janë pajtuar menjëherë pas veprës penale, i dëmtuari nuk ka kërkuar që të dënohet dhe nuk ka kërkuar kompensim dëmi ndaj të pandehurit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata vetëm faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ndonjë rrethanë tjetër nuk gjeti. Gjykata të akuzuarin e gjykon me dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitivin e nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P. nr. 77/20, datë 07.02.2022

Zyrtarja Ligjor,
Albane MORINA

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.